



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5705 prot

Roskovec, më 21.06.2025

V E N D I M

NR 34 .DATË 30.06.2025

"PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË PARË TË PBA 2026-2028"

Mbështetur në nenin 9 pika 1.3 dhe neni 41 të ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", në nenin 36 të ligjit Nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH" të ndryshuar; ligjin Nr.10296 datë 08.06.2018 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, Udhëzimin Nr.23 datë 30.07.2018, "Për procedurat dhe standartet të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisë të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin Nr.10296 datë 08.06.2018 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm të njësisë të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin Nr.8 datë 28.02.2025 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm të njësisë të vetëqeverisjes vendore", si dhe materjaleve të sjella nga Drejtoria Ekonomike; Këshilli i Bashkisë,

- V E N D O S I :

1. Të miratojë Dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 (Faza I) për Bashkinë dhe njësisë shpenzuese në vartësi, sipas tabelave bashkëlidhur siç dhe janë ngarkuar në sistemin informatic të bashkisë.
- a. Raporti PBA1: Tavanet Përfundimtare të PBA
- b. Raporti PBA2: Parashikimi i të Ardhurave
- c. Raporti PBA3: Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit Ekonomik
- d. Raporti PBA4: Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit FunkSIONAL (Niveli I, II, III I COEF)
- e. Raporti PBA5: Shpenzimet sipas programit dhe Klasifikimit Ekonomik
- f. Raporti PBA6: Deklarata e Politikës së programit
- g. Raporti PBA7: Shpenzimet e Produkteve të programit
- h. Raporti PBA8: Projektet e Investimeve

- i. Raporti PBA9: Informacion mbi NJVQV / PROGRAMIN
 - j. Shtojca 2. Struktura e Dokumentit të PBA Vendor 2026-2028
2. Ngarkohen ekzekutivi i bashkisë për zbatimin e këtij vendimi për vazhdimin e punës së mëtejshme të përgatitjes së PBA 2026-2028 sipas këtij dokumenti .
 3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

